

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Furnizim varja dhe lubrifikantë për mjetet e Bashkisë Kolonjë, viti 2026.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Vajra motorike - 09211100-2

Lubrifikantët - 24951100-6

1. VLERA E FONDIT LIMIT: 1,135,975.0 (njëmilionenjëqindetridhjetëepesëmijëenëntëqindeshtatë dhjetëepesë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit **21**, pika **2**, të Ligjit nr.**162/2020** “Për prokurimin publik”, nenit **2**, pika **2/c**, i ndryshuar me ligjin nr.**16** datë.**08.02.2024** dhe nenit **78**, pika **2**, të VKM nr. **285**, datë **19.05.2021**“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë** ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar: Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023-2024-2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e

periudhës së kërkuar **duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur e fondit limit që prokurohet.**

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”**,ku parashikohet se: “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.*

si dhe bazuar nënenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,parashikohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nënkufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

*Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e vlerës së fondit limit** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. “ pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.*

2.2.2 Operatori/et ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku

operatori ushtron aktivitet **për vitin 2026 këstet e maturuara** (Sipas QKB), sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore .

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.*

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, **në një vlerë jo më të vogël se 20 %** të vlerës së **përlllogaritur e fondit limit** që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje**).*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të vogël se 20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën e cilësisë **SSH/EN/ISO 9001:2015** (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), ose ekuivalente, e cila duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijë objektin e prokurimit, për rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është prodhues i mallit. Për rastet kur operatori ekonomik pjesëmarrës nuk është prodhues i mallit duhet të paraqesë një vetëdeklarim në të cilin të deklarojë se furnizuesi është konform standarteve të cilësisë. *(Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).* Vendosja e SSH/EN/ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për

zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj SSH/EN/ISO 9001:2015 rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë. Paisja me këtë certifikatë SSH/EN/ISO, garanton që OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit,*, si edhe në Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standartit si SSH/EN/ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i SSH/EN/ISO -s rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial që vërteton pajtueshmërinë e produktit me specifikimet teknike, fletë e analiza të lëshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4 Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori për mallin objekt prokurimi shoqëruar me katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku të dallohen qartë specifikimet teknike të saj. Në rastin e autorizimit me distributorin të dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur pasi është në përputhje me objektin e prokurimit dhe bazuar në nenin 40, pika 6 gërma b dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur që operatori ekonomik që do të ofertojë, do të ofrojë produkte të çertifikuara të një cilësie të mirë e në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike, termat e referencës dhe përllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.265 me nr.3481 prot, datë.08.06.2026, pjesë përbërëse e strukturës së **Bashkisë Kolonjë**, në përputhje me nenin 36, të ligjit

nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet Teknike dhe termat e referencës janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i përlogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të prevetivit të përgatitur nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike, termat e referencës dhe përlogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.265 me nr.3481 prot, datë.08.06.2026, pjesë përbërëse e strukturës së **Bashkisë Kolonjë**, në bazë të Katalogut “Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike 2024”.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt, “**Furnizim Varja dhe lubrifikantë për mjetet e Bashkisë Kolonjë, viti 2026**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali: Dokumentat e tenderit, Preventivi, Specifikimet teknike

Njësia e Prokurimit